

TË SAPOARDHUR NË GJERMANI?

Albanisch

Informacione dhe këshilla
rreth shkollës në Berlin

Përgjegjësjë e senatit
për integrim dhe migrim

Senatsverwaltung
für Arbeit, Soziales, Gleichstellung, Integration,
Vielfalt und Antidiskriminierung

Senatsverwaltung
für Bildung, Jugend
und Familie

BERLIN



Dëftuesi

Botuesja

Administrata e senatit për arsim, adoleshencën dhe familjen
Bernhard-Weiß-Straße 6, 10178 Berlin

Administrata e senatit për punë, barazinë sociale, integrim, larmi dhe anti-diskriminim
Përgjegjësja e senatit të Berlinit për integrim dhe migrim
Potsdamer Straße 65, 10785 Berlin
www.integrationsbeauftragte.berlin.de

Informacionet aktuale i gjeni në faqen tonë të internetit:

www.berlin.de/sen/bjf

Ose na ndiqni në këto shërbime:

 www.twitter.com/senbjf

 www.instagram.com/senbildjugfam

 www.facebook.com/senbildjugfam

 www.youtube.com/senbjf

Redaksia

SenBJF: Elke Biester, I A 1.8; Sibylle Behnes, O5 I Klä SenBJF; Referati ZS I

Faqosja

SenBJF, Referati ZS I

Përkthimi

FRANK Publishing GmbH

Fotografitë

Annette Koroll, Michael Kuchinke-Hofer, MeinSprossimFokus, Jannette Kneisel,
Getty Images (JGI Jamie Grill, Maskot, Klaus Vedfelt), iStock (Tempura)

Tirazhi

Tirazhi i tretë i përpunuar, mars 2024

Kjo broshurë është pjesë e punës reklamuese të Landit Berlin. Ajo nuk është
destinuar për shitje dhe nuk lejohet të përdoret për fushata të partive politike.

Katharina Günther-Wünsch

Senatorja për arsim, adoleshencën dhe familjen



Katarina Niewiedzial

Përgjegjësjë për integrim dhe migrim



Të dashur prindër,

gëzohemi të ju përshëndesim ju dhe fëmijët tuaj në Berlin. Berlini është një qytet i hapur për gjithë botën, në të cilin jetojnë njerëz me prejardhje më të ndryshme. Senati i Berlinit është i obliguar të vë në dispozicion një vend shkollor për të gjithë fëmijët në moshën e detyrimit shkollor. Për fëmijët nën moshën gjashtë vjeçe si shtesë ekzistojnë shumë oferta kujdesie në kopshtet e fëmijëve, gjithnjë e më shpesh edhe me oferta në dy gjuhë. Kështu që nga fillimi nxitet gjuha e vendit të origjinës përveç gjermanishtes dhe bëhet një pikë e fortë tek fëmijët. Sidomos për fëmijët, që sapo kanë ardhur në Berlin, ofertat e shkollimit janë të rëndësishme: Kopshtet e fëmijëve dhe shkollat japin rregullsi për jetën e përditshme dhe mundësojnë kontakte shoqërore, fëmijët atje mësojnë për jetën dhe gjejnë shoqe të reja dhe shokë të rinj.

Një element i rëndësishëm për jetën në Gjermani është kuptimi i gjuhës. Për javët e para ose muajit e parë pas ardhjes nga jashtë shtetit, fëmija juaj mund të vizitojë në Berlin një klasë të mirëseardhjes për të marrë në këtë mënyrë qëllimisht përkrahje në mësimin e gjuhës gjermane. Grupet mësimore janë më të vogla, zhvillohet një nxitje e qëllimshme gjuhësore. Aktivitetet e tjera shkollore me patjetër zhvillohen bashkërisht me të gjitha nxënëset dhe të gjithë nxënësit. Në momentin që fëmija juaj ka fituar mjaft njohuri në gjuhën gjermane, ai kalon në një klasë të rregullt.

Pas përfundimit të shkollës fillore, sistemi i arsimit në Berlin ofron shumë mundësi. Fëmija juaj kalon në një shkollë të integruar sekondare ose në një gjimnaz. Diplomën e tij shkollore ai e fiton pas 10 deri në 13 vjetësh të ndjekjes së shkollës. Adoloshentët në vijim normalisht fillojnë me formimin e tyre dual për profesion ose me studimet. Në shkollat me mësimdhënie gjatë gjithë ditës në Berlin ofrohet një kujdestari për fëmijët deri në orën 16. Kjo është një përkrahje e madhe për prindërit e punësuar.

Shkollat e Berlinit ua mundësojnë të gjithë fëmijëve pjesëmarrjen në jetën shoqërore. Prandaj në këtë doracak gjeni gjithashtu informacione për pjesëmarrjen në ekskursionet ose udhëtimet e klasës dhe për ofertën e një dreke falas.

Shpresojmë, që me këtë broshurë t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja rreth shkollës në Berlin. U urojmë fëmijëve tuaj kënaqësi në të nxënimit dhe shumë suksese në rrugën e tyre të arsimit.

Ju përshëndesin përzemërsisht

Katharina Günther-Wünsch *K. Niewiedzial*

Katharina Günther-Wünsch

Katarina Niewiedzial

Mirë se erdhët në Berlin 



Broshurën e gjeni në internet në gjuhë të ndryshme.

Atje gjeni edhe informacione të mëtejshme për persona të arratisur rreth temave të mbrojtjes së fëmijëve, kopshtit të fëmijëve, shkollës, maturës si dhe rreth formimit profesional dhe profesionit në Berlin.

PËRMBAJTJA

Detyrimi shkollor - me qëllim që të gjithë të mësojnë diçka	4
Si mund të përkrahni fëmijën tuaj	6
Në shkollë gjithë ditën - një vend për të nxënë dhe për të jetuar	8
Shanset e barabarta për të gjithë me pakon e arsimit	10
Hapat më të rëndësishme në vitin para hyrjes në shkollë	14
Para fillimit të shkollës: të nxënit duke luajtur në kopshtin e fëmijëve	16
Nxitja e gjuhës - përgatitja e mirë për kohën shkollore	18
Mësimi i gjermanishtes në shkollë	20
Shkollat gjatë pushimeve në Berlin për persona të arratisur	22
Të drejtat dhe detyrat e nxënëseve dhe nxënësve	24
Kështu prindërit mund të marrin pjesë në modelimin e shkollës	26
Sistemi shkollor i Berlinit	28
Ndërrimi i vendbanimit në një qark tjetër bashkiak - a duhet të ndërrohet shkolla apo të mos ndërrohet?	32
Adresat dhe kontaktet	36



DETYRIMI SHKOLLOR - ME QËLLIM QË TË GJITHË TË MËSOJNË DIÇKA

Në Gjermani ekziston një detyrim shkollor. Nëse fëmija juaj ka arritur moshën gjashtë vjeçare ose më shumë, atëherë ai duhet të shkojë në shkollë. Detyrimi shkollor zgjat dhjetë vjet të ndjekjes së shkollës dhe mbaron më se voni, kur fëmija juaj arrin moshën 18 vjeçare. Edhe më pas fëmija juaj ka mundësinë të ndjekë një shkollë.

Detyrimi shkollor do të thotë gjithashtu, që fëmija juaj nuk lejohet të mungojë në shkollë.

Fëmija juaj duhet të shkojë në shkollë, edhe nëse nuk ka qejf ose nëse ju keni nevojë për atë për të përkthyer për ju pranë autoriteteve shtetërore ose sepse duhet të kujdeset për motra apo vëllezër të vegjël.

Fëmija juaj është i sëmurë dhe nuk mund të shkojë në shkollë?

Atëherë ju lutemi të telefononi në po atë ditë sekretariatit e shkollës dhe bëni njoftimin. Gjithashtu duhet të shkruani një kërkesë ndjese. Kjo shkresë duhet të jetë në shkollë më se voni pas tri ditësh.

Nëse fëmija juaj mungon pa ndjesë, atëherë shkolla do të kërkojë një bisedë me ju.

Do të bëhet një shënim në dëftesë ose në raportin e gjendjes mësimore. Nëse fëmija juaj mungon më shpesh pa ndjesë, atëherë mund të ndodhë që ju duhet të paguani një gjobë.

SI MUND TË PËRKRAHNI FËMIJËN TUAJ

Parimisht në shkollat gjermane vlen: Ju si prindër nevojiteni! Sepse ju e njihni fëmijën tuaj më mirë. Flisni me mësuesin, nëse merakoseni ose nëse keni pyetje. Kësisoj e ndihmoni fëmijën tuaj dhe e përkrahni atë. Sepse sa më shumë të dijë mësuesi për fëmijën tuaj, aq më mirë fëmija mund të marrë përkrahje.

→ Korrektësia kohore

Kujdesuni, që fëmija juaj të çohet me kohë dhe që të jetë në shkollë në orën e duhur. Nëse familja juaj banon më larg nga shkolla: Ju lutemi të sillni fëmijën tuaj në shkollë në kohën e duhur dhe ta merrni atë gjithashtu në kohën e duhur. Se kur fillon dhe mbaron dita shkollore, kjo është shënuar në orarin mësimor.

→ Gjumi

Fëmija juaj ka nevojë për mjaft gjumë për të qenë i çlodhur për të nxënit. Veçanërisht në kohën e parë mësimi është posaçërisht rëndues për fëmijën tuaj, sepse nuk zhvillohet në gjuhën e tij amtare.

→ Çanta e shkollës

A e ka përgatitur fëmija juaj çantën e shkollës? A është futur gjithçka, çfarë atij i nevojitet për ditën: lapsat, fletoret, librat, rrobat e sportit, diçka për të ngrënë dhe për të pirë?

→ Rrobat

Ju lutemi të kujdeseni, që fëmija juaj të mbajë rrobat, që u përshtaten stinëve. Në disa shkolla ekziston zakoni, që fëmijët të veshin shapka.

→ Mësimi i fizkulturës

Përgatitni rrobat e përshtatshme për mësimin e fizkulturës. Të gjithë fëmijët, domethënë vajzat dhe djemtë, duhet të marrin pjesë në mësimin e fizkulturës.

→ Rruga deri tek shkolla

Ju lutem të bëni rrugën deri tek shkolla me fëmijën tuaj më përpara dhe të shpjegoni atij vendet posaçërisht të rrezikshme. Ndoshta fëmija juaj mund të bëjë rrugën deri tek shkolla edhe bashkë me fëmijë të tjerë.



→ Vakti i mëngjesit

Ju lutem të kujdeseni, që fëmija juaj të ketë ngrënë diçka, para se të dalë nga shtëpia, dhe që ai të marrë me vete në shkollë një vakt të dytë mëngjesi dhe diçka për të pirë.

→ Dreka

Për klasat 1 deri 6, dreka në shkollë është falas. Që nga klasa e shtatë, fëmija juaj gjithashtu mund të hajë një drekë falas, nëse e parashton kartën berlinpass-BuT.

→ Detyrat shtëpiake

Ju lutemi të kujdeseni që fëmija juaj të bëjë gjithmonë detyrat e tij shtëpiake ose detyrat e tij mësimore. Për këtë arsye është nevoja që ai të ketë një vend të qetë, ku mund të punojë pa trazime. Nuk ka problem, nëse fëmija juaj nuk kupton ose nuk arrin të bëjë diçka menjëherë. Pyesni në një rast të fillë, nëse ai mund të marrë ndihmë nga fëmijët e tjerë të klasës ose nga mësuesit.

→ Nxitja dhe kujdestaria

Në shkollat fillore, shkollat me nxitje të theksuar sipas pedagogjisë speciale, në shkollat sekondare të integruara dhe në shkollat e përbashkëta ka një ofertë të gjerë nxitjeje dhe kujdestarie përmes kujdestareve dhe kujdestarëve të provuar, që është një ofertë shtesë përveç mësimdhënies. Këto aktivitete në shumicën e rasteve zhvillohen në pasdite. Atje fëmijët mund të luajnë së bashku, mund të bëjnë punë krijuese, sport, muzikë ose ekskursione. Këtu mund t'i kryejnë gjithashtu detyrat mësimore.

NË SHKOLLË GJITHË DITËN - NJË VEND PËR TË NXËNË DHE PËR TË JETUAR

Shumica e shkollave në Berlin janë shkolla me mësimdhënie gjatë gjithë ditës. Kjo gjë është e mirë për fëmijën tuaj dhe për ju si prindër: Fëmija juaj ndodhet në një kujdestari të mirë dhe ju keni kohë për kurse gjuhe, formim profesional, punësim dhe gjëra të tjera.

Shkollat fillore dhe shkollat me nxitje të theksuar sipas pedagogjisë speciale

Në shkollat e hapura me mësimdhënie gjatë gjithë ditës fëmijët tuaj ndodhen në kujdestari të besueshme në klasat 1 deri 6 që nga ora 7:30 deri në orën 13:30, edhe nëse mësimdhënia nganjëherë fillon më vonë ose mbaron më herët.

Në shkollat e mbyllura me mësimdhënie gjatë gjithë ditës, fëmijët tuaj duhet të jenë të pranishëm që nga ora 7:30 deri në orën 16:00 në katër ditë të javës. Në këtë sistem mësimdhënie dhe ofertat e mësimi si dhe ofertat e argëtimit alternojnë. Ju nuk duhet të paguani asgjë për këtë. Të gjithë fëmijët në shkollën e hapur me mësimdhënie

gjatë gjithë ditës mund të shfrytëzojnë oferta shtesë në kujdestari që nga ora 13:30 deri në orën 16:00. Për klasat 1 deri 3 kjo ofertë është falas. Pjesëmarrja është e mundur edhe gjatë pushimeve.

A jeni i/e punësuar apo bëni një formim profesional ose një formim të mëtejshëm? A duhet të ketë një kujdestari për fëmijën tuaj kësaj para orës 7:30 dhe/ose pas orës 16:00? Edhe në një rast të tillë mund të parashtroni kërkesë për nxitje dhe kujdestari shtesë. Formularin e merrni në shkollën fillore, në entin për çështjen e të miturve ose në internet.

Ju lutem të dorëzoni kërkesën e plotësuar në shkollën fillore.



Informacionet për shkollën fillore



Formulari i kërkesës për
nxitje dhe kujdestari shtesë





Shkollat e mëtejshme

Në shkollat e mëtejshme ekzistojnë tri forma për mësimin gjatë gjithë ditës. Mësimdhënia gjatë gjithë ditës quhet ose e hapur, ose e mbyllur ose e mbyllur pjesërisht.

E hapur do të thotë, që nxënëset dhe nxënësit pas mësimdhënies deri në orën 16:00 vullnetarisht mund të shfrytëzojnë ofertat shtesë.

E mbyllur do të thotë, që shkolla në katër ditë të javës zgjat deri në orën 16:00, në ditën e pestë deri në mbarimin e mësimdhënies. Në këtë sistem alternojnë gjatë ditës mësimdhënia dhe ofertat shtesë të mësimin dhe të argëtimit.

E mbyllur pjesërisht do të thotë një përzjerje e të dyja formave: shkollë me mësimdhënie gjatë gjithë ditës në formë të hapur për dy ditë dhe në formë të mbyllur për dy ditë.

Nxitja dhe kujdestaria

Nxitja dhe kujdestaria jashtë mësimdhënies i ofron fëmijës tuaj organizime të ndryshme të sportit, të muzikës, të arteve, të lojës dhe të argëtimit.

Shtohen shumë mundësi nxitjeje dhe përkrahjeje, si për shembull nxitja e gjuhës ose ndihma në detyrat mësimore.

Pjesëmarrja në drekë është falas në klasat 1 deri 6 dhe në shkollën e mbyllur me mësimdhënie gjatë gjithë ditës është e obliguar. Në shkollën sekondare, fëmija juaj gjithashtu mund të marrë një drekë falas, nëse e parashton kartën berlinpass-BuT.

SHANSET E BARABARTA PËR TË GJITHË ME PAKON E ARSIMIT



Synohet, që të gjithë fëmijët të marrin një arsim të mirë dhe që të mund të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe kulturore. Si lehtësim financiar për familjet me të ardhura të ulëta ekziston një përkrahje financiare nga pakoja e arsimit për to, për shembull për aktivitete shkollore dhe argëtuese.

Përkrahjet financiare nga pakoja e arsimit i merrni nga po ajo zyrë, ku tashme keni parashtruar kërkesë për pagesat e tjera:

- Është enti “Jobcenter”, nëse merrni pagesën “Bürgergeld”.
- Është zyra për përkrahjen e banimit (Wohngeldstelle), nëse merrni përkrahjen e banimit dhe pagesën shtesë për fëmijët.
- Është enti për çështjet sociale, nëse merrni ndihmë sociale.
- Është enti i Landit për çështjet e personave të arratisur, nëse merrni pagesa si azilkërkues.

Pakoja e arsimit dhe berlinpass-BuT

Për të marrë pagesa nga pakoja e arsimit, në shumicën e rasteve fëmijës tuaj i nevojitet karta berlinpass-BuT. Shkurtimi “BuT” do të thotë “Arsimi dhe Pjesëmarrja”.



Informacionet për pakon e arsimit



Këshillimi rreth BuT në gjuhë të ndryshme



Këto ndihma i merrni me kartën berlinpass-BuT dhe me pakon e arsimit

→ Dreka në shkollë

Për klasat 1 deri 6, dreka në shkollë është falas. Që nga klasa e shtatë, fëmija juaj gjithashtu mund të hajë një drekë falas, nëse e parashton kartën berlinpass-BuT.

→ Materialet e nevojshme për shkollën

Për materialet personale, që i nevojiten fëmijës tuaj për shkollën, si për shembull fletoret, lapsat ose çantën e shkollës, ju merrni një përkrahje financiare prej 174 Eurosh në vit.

→ Nxitja e të nxënit

Shkolla shqyrton, nëse fëmija ju mund të arrijë një qëllim të rëndësishëm mësimor me nxitjen shtesë të të nxënit. Këtu bëjnë pjesë për shembull një diplomë shkollore, kalimi në ciklin e lartë të gjimnazit ose një kompetencë e përmirësuar gjuhësore.

Pyesni në shkollë për mundësitë e nxitjes shtesë të të nxënit për fëmijën tuaj.

→ Ekskursionet njëditore

Fëmija juaj mund të marrë pjesë falas në ngjarjet njëditore shkollore. Këto ngjarje mund të jenë piknikët e klasës, ditët për shtegtimin, ekskursionet ose projektet. Për këtë mundësi duhet t'ia tregoni shkollës sa më shpejt kartën berlinpass-BuT. Vetëm paratë e xhepit dhe ushqimin duhet t'i paguani vetë.

→ Udhëtimet e klasës

Kostot për pjesëmarrjen në udhëtimin disaditëshe të klasës merren plotësisht përsipër. Për këtë mundësi duhet të parashtroni pranë zyrës suaj të pagesave një vërtetim të konfirmuar nga shkolla. Formularin e gjeni në internet: www.berlin.de/bildungspaket



→ Kultura, sporti, argëtimi

Zyra e pagesave merr përsipër një paushall prej 15 Eurosh në muaj, kështu që fëmija juaj mund të marrë pjesë në ofertat sportive, kulturore dhe në oferta të tjera argëtuese.

Mund të jenë mësimi muzikor ose aktivitetet në shoqatat sportive, në institucionet për argëtimin dhe në federatat për adoleshentët. Por këtë pjesëmarrje duhet ta vërtetoni, për shembull përmes një anëtarësie ose një vërtetimi pjesëmarrjeje.



Veç këtyre kushteve, fëmija juaj duhet të jetë nën moshën 18-vjeçare. Përkrahjen mujore financiare gjithashtu mund ta kurseni, për shembull, nëse fëmija juaj dëshiron të marrë pjesë në një udhëtim gjatë pushimeve.

Një përkrahje tjetër prej 15 Eurosh mund ta merrni për blerjen ose huazimin e pajisjeve si rroba sportive ose vegla muzikore dhe për kostot e rrugës për tek ofertat. Ju lutem të vërtetoni këto shpenzime përmes faturave përkatëse ose përmes llogaritjeve të kostove.

→ Mjetet e transportit publik

Bileta e nxënësve për zonën AB të transportit publik të Berlinit është falas për fëmijën tuaj. Për fëmijët e shkollës, që shfrytëzojnë zonën e tarifës ABC, shpërblehen kostot e rrugës për në shkollë nga ana e zyrës suaj të pagesave.

Biletën e nxënësve porosisni në internet. Për këtë biletë duhet të ngarkoni një fotografi pasaporte dhe kartën e nxënësit, të cilën e posedon fëmija juaj.



Marrja e biletës së nxënësve
si abonim 

HAPAT MË TË RËNDËSISHËM NË VITIN PARA HYRJES NË SHKOLLË



Shtatori-tetori

Dita e dyerve të hapura nëpër shkollat

Prindërit dhe fëmijët mund ta këqyrin shkollën, të bëjnë pyetje dhe të njohin mësuesit si dhe fëmijët e tjerë të shkollës.

Regjistrimi për shkollën dhe për nxitjen dhe kujdestarinë shtesë

Kur për fëmijën tuaj fillon detyrimi shkollor, ju do të merrni një letër nga shkolla juaj kompetente. Atë e sillni me vete në shkollë dhe atje e regjistroni fëmijën tuaj personalisht për shkollën dhe për nxitjen dhe kujdestarinë shtesë.

Nëntori-maji

Vizita tek mjeku shkollor

Para hyrjes në shkollë, fëmija juaj duhet të vizitohet nga një mjek. Gjatë kësaj vizite, mjekja shkollore ose mjeku shkollor vlerëson, sa mirë fëmija juaj dëgjon, shikon, flet, lëviz dhe sa i përparuar është ai në zhvillimin mendor dhe fizik.

Fëmijët, që ende nuk kanë pjekurinë shkollore dhe posedojnë një vend në një kopsht fëmijësh, lejohen të hyjnë në shkollë një vit më vonë.



Maji

Informacionet për vendin shkollor

Ju do të merrni një letër nga shkolla e ardhshme e fëmijës tuaj.

Maji-qershori

Ngjarja informuese për prindërit

Shkolla e fëmijës tuaj ju fton për një mbledhje prindërore. Këtu do të merrni informacione të rëndësishme për fillimin e shkollës. Gjatë mbledhjes do të njiheni me mësuesit dhe prindërit e tjerë.

Korriku-gushti

Festa e hyrjes në shkollë

Të shtunën para ditës së parë të shkollës, fëmijët dhe prindërit festojnë pranë shkollës së re hyrjen në shkollë. Me këtë rast, në Gjermani prindërit u dhurojnë fëmijëve të tyre në shumicën e rasteve një kaush sheqerkash me surpriza të vogla.

Fillimi i vitit shkollor

Në javët e para të shkollës, fëmijët dhe mësuesit njihen me njëri-tjetrin. Për prindërit zhvillohet një mbrëmje prindërore.

PARA FILLIMIT TË SHKOLLËS: TË NXËNIT DUKE LUAJTUR NË KOPSHTIN E FËMIJËVE

Të gjithë fëmijët në Gjermani, të cilët ende nuk janë në moshën e detyrimit shkollor, mund të shkojnë në një kopsht fëmijësh (Kita). Këtë të drejtë e mban çdo fëmijë në Gjermani që nga moshja një vjeçare.

Ndjekja e një kopshti fëmijësh është e mirë për fëmijën tuaj dhe e mirë për ju

- Këtu fëmija juaj mund të luajë me fëmijë të tjerë, mund të lëvizë, të mësojë gjermanisht dhe shumë të tjera.
- Fëmija juaj gjen shoqe të reja dhe shokë të rinj, njihet me Berlinin dhe përgatitet për shkollën.
- Derisa fëmija juaj ndodhet në kujdestari në kopshtin e fëmijëve, edhe ju keni kohë të mësoni gjermanisht, të bëni një formim profesional ose të punoni.
- Në kopshtin e fëmijëve mund të njiheni me familje të tjera dhe mund të lidhni kontakte.

Ndjekja e një kopshti fëmijësh është falas.

Ju duhet të paguani vetëm për drekën, nëse fëmija juaj nuk e ka kartën berlinpass-BuT.

→ shih faqet 11 dhe 12

Të gjeni një kopsht fëmijësh dhe të parashtroni kërkesë për bonon

Me qëllim që fëmija juaj të mund të ndjekë një kopsht fëmijësh, ju duhet të parashtroni kërkesë për një bono për kopshtin e fëmijëve pranë entit për çështjet e të miturve të qarkut bashkiak, ku banoni.

Formularin mund ta merrni pranë entit për çështjet e të miturve, pranë shërbimit social, në strehimoret e përbashkëta ose në internet.

Në bonon për kopshtin e fëmijëve ka një shënim, që nga çfarë date dhe për sa kohë në ditë fëmija juaj lejohet ta ndjekë kopshtin e fëmijëve. Nëse keni gjetur një kopsht fëmijësh me një vend të lirë për fëmijën tuaj, atëherë mund të thyni bonon atje.



Të kërkonti një vend në një kopsht fëmijësh

Nga që shumë familjeve u nevojitet një vend në një kopsht fëmijësh, rekomandohet të filloni sa më herët me kërkimin. Për vende të lira në kopshtet e fëmijëve mund të kërkonti në internet. Ose këshilloheni dhe ndihmoheni nga ana e entit për çështjet e të miturve.



Navigacioni për kopshtet e fëmijëve 

NXITJA E GJUHËS - PËRGATITJA E MIRË PËR KOHËN SHKOLLORE

Afërsisht 18 muaj para se të hyjë fëmija juaj në shkollë, specialistët në kopshtin e fëmijëve konstatojnë, sesa mirë fëmija juaj tashme flet dhe kupton gjermanisht. Nëse nga ky konstatim i gjendjes gjuhësore rezulton, që fëmijës tuaj ende i nevojitet përkrahje, atëherë ai merr në kopshtin e fëmijëve një nxitje të qëllimshme gjuhësore.

Në konstatimin parashkollor të gjendjes gjuhësore duhet të marrin pjesë të gjithë fëmijët në Berlin. Kjo vlen gjithashtu për fëmijët, që nuk shkojnë në kopshtin e fëmijëve. Ju do të merrni një ftesë shkrimore për pjesëmarrjen nga ana e entit arsimor të qarkut tuaj të banimit.



Informacionet për nxitjen e gjuhës në gjuhë të ndryshme 

Nxitja e aftësive të gjermanishtes për fëmijët, që nuk ndjekin kopshtin e fëmijëve

Nëse rezulton, që fëmija juaj akoma nuk flet gjermanisht aq mirë dhe që atij i nevojitet një përkrahje në mësimin e gjuhës, atëherë ai duhet të marrë pjesë në një nxitje gjuhësore. Për këtë qëllim do të merrni një bono për nxitje gjuhësore nga ana e entit tuaj arsimor. Me këtë bono, fëmija juaj mund të ndjekë nxitjen gjuhësore në një kopsht fëmijësh afër banesës suaj.

Nxitja zhvillohet në çdo ditë të javës për pesë orë dhe zgjat 18 muaj - që nga 1 shkurti deri në 31 korrik të viti vijues.

Me rëndësi:

Bonoja për nxitjen gjuhësore është ndryshe nga bonoja e kopshtit të fëmijëve.

Me bonon e kopshtit të fëmijëve, fëmija juaj normalisht mund të ndjekë për shtatë orë në një kopsht fëmijësh të zgjedhjes suaj.

Bonon për nxitjen gjuhësore mund ta thyni vetëm në disa kopshte fëmijësh ose institucione të caktuara, të cilat ofrojnë një nxitje parashkollore gjuhësore. Atje për fëmijën tuaj ofrohet përkujdesja dhe nxitja çdo ditë për pesë orë.

Një listë me grupet për nxitjen gjuhësore mund të merrni pranë entit tuaj kompetent për çështjet e të miturve.

„Arsimi i hershëm në vendstrehim“ - Oferta e nxitjes në strehimoret e përbashkëta

Në disa strehimore të përbashkëta ose në institucionet përreth, fëmijët nga familjet, që nuk kanë një banesë të veten dhe as nuk kanë një vend në një kopsht fëmijësh, mund të shfrytëzojnë ofertën gjysmë-ditore “Arsimi i hershëm në vendstrehim” (FBO).

Si përgatitje për kopshtin e fëmijëve ose shkollën, në këtë ofertë fëmija juaj mëson gjermanisht në grupe të vogla, mund të luajë dhe të gjejë shoqe dhe shokë. Një specialist përkthyes është gjithashtu i pranishëm atje. Ky mund t’ju përkrahë edhe në kërkimin e një vendi në një kopsht fëmijësh. Informacionin, se ku mund të gjeni një ofertë FBO, e merrni pranë zyrave të bonove në entin për çështjet e të miturve. Atje gjithashtu parashtrooni kërkesë për bonon e kopshtit të fëmijëve të nevojshme për ofertat FBO.

MËSIMI E GJERMANISHTES NË SHKOLLË

Klasat e mirëseardhjes

Klasat e mirëseardhjes janë grupe mësimore për nxënëset e reja dhe nxënësit e rinj, që ende nuk zotojnë gjermanisht. Synimi i këtyre klasave është ta ndihmojnë fëmijën tuaj, që të mësojë gjermanisht sa më shpejt në një grup të vogël dhe që të ambientohet në sistemin arsimor gjerman.

Nëse fëmija juaj deri më tani nuk ka ndjekur asnjë shkollë ose ende nuk di lexim dhe shkrim ose nuk njih shkrimin latin, atëherë edhe këto gjëra i mëson në një klasë të mirëseardhjes.

Synohet, që fëmija juaj në momentin, që e zoton mjaft mirë gjuhën gjermane, të kalojë në një klasë të rregullt, e cila përkon me moshën dhe njohurinë e tij.

Në klasat e mirëseardhjes nuk lëshohen dëftesa. Në vend të këtyre lëshohen raporte mbi gjendjen mësimore. Mësuesi përpilon një raport të tillë për çdo nxënës dhe çdo nxënës në mbarim të semestrit dhe të viti shkollor.

Raporti dokumenton përparimet mësimore në gjermanisht, në lëndët e tjera mësimore si dhe në

mënyrën e angazhimit dhe në sjelljen shoqërore. Atje shënohet gjithashtu, sa ditë fëmija juaj ka munguar në mësimdhënie ose ka ardhur me vonesë - me ndjesë dhe pa ndjesë. Raporti mbi gjendjen mësimore përmban edhe një rekomandim, nëse fëmija juaj duhet të rrijë akoma në grupin mësimor ose të kalojë në një klasë të rregullt.

Synohet, që nxënëset dhe nxënësit, që sapo kanë nisur filloren, të ndjekin mundësisht drejtpërsëdrejti mësimdhënien e rregullt në fazën e nisjes së shkollës. Fëmijët më të mëdhenj qëndrojnë normalisht jo më shumë se një vit në një klasë të mirëseardhjes.

Në disa lëndë të caktuara si muzikë, arte dhe sport synohet, që fëmijët dhe adoleshentët nga klasat e mirëseardhjes të marrin pjesë në mësimdhënien e rregullt mundësisht që nga fillimi.



Zyrat koordinuese për klasat e mirëseardhjes
në qarqet bashkiakë të Berlinit





Oferta mësimore “gjuha e parë”

Në disa shkolla, fëmija juaj mund të marrë dy orë mësim shtesë në javë në gjuhën e tij të parë. Aty nxënëset dhe nxënësit mësojnë lexim dhe shkrim në gjuhën e familjeve të tyre. Ky është favori: Nëse fëmija juaj e zotin mirë gjuhën e tij të parë, atëherë ai do të mësojë edhe më lehtë gjermanisht si dhe gjuhë të tjera të huaja dhe përmbajtjet e lëndëve.



Informacionet dhe regjistrimi për
mësimdhënien në gjuhën e parë (ESU) 

SHKOLLAT GJATË PUSHIMEVE NË BERLIN PËR PERSONA TË ARRATISUR

Në shkollën gjatë pushimeve, fëmijët e sapoardhur në Berlin mund ta përmirësojnë gjermanishten e tyre, të zbulojnë Berlinin, të provojnë gjera të reja dhe të kalojnë kohë së bashku me bashkëmoshatarët.

Nxitja e gjuhës, arsimit dhe pjesëmarrja

Shkollat gjatë pushimeve zhvillohen në pushimet e pashkëve, të verës dhe të vjeshtës. Ka shumë oferta krijuese për grupmoshat e ndryshme në gjithë Berlinin. Fëmijët dhe adoleshentët bëjnë filma, marrin pjesë në ekskursione, luajnë teatër, merren me muzikë ose sport, për shembull futboll, kërcim, biçikleta, skateboard ose alpinizëm.

Mësuesit i përkrahin gjatë mëimit të gjermanishtes dhe i informojnë rreth rrugëve të arsimit dhe mundësive të mëvonshme profesionale.

Të marrësh pjesë - por si?

Pjesëmarrja është vullnetare dhe falas, por pas regjistrimit është e obliguar.



Informacionet dhe
regjistrimi për shkollën gjatë
pushimeve në Berlin





Gjuha dhe jeta e përditshme - kurset për prindërit

Në kurset prindërore pranë shkollave të larta popullore të Berlinit, nënat, baballarët dhe personat me përgjegjësi prindërore nga familjet e sapoardhur mund të mësojnë gjuhën gjermane dhe shumë gjëra rreth sistemit arsimor gjerman dhe të Berlinit.

Këtu përfshihen tema si jeta e përditshme familjare dhe shkollore, edukimi i fëmijëve, shëndeti dhe aktivitete argëtuese. Me këto njohuri, ju mund ta përkrahni mirë fëmijën tuaj në rrugën e tij arsimore.

Kurset zhvillohen tri herë në javë - në shumicën e rasteve gjatë kohës, kur fëmija juaj është në shkollë ose në kopshtin e fëmijëve. Nganjëherë kurset janë në po atë shkollë ose kopsht fëmijësh, nganjëherë shumë afër.

Disa kurse ofrojnë edhe një kujdestari fëmijësh. Me shumë informacione mund të merrni në çdo shkollë të lartë popullore.




Kurset e gjermanishtes për prindërit
në shkolla dhe kopshtët e fëmijëve



TË DREJTAT DHE DETYRAT E NXËNËSEVE DHE NXËNËSVE





Fëmijët kanë të drejtat e bashkë-vendosjes dhe të bashkë-ndikimit. Në klasën ose grupin mësimor të tyre ata zgjedhin përfaqësuesit e tyre si nxënës. Këta përfaqësojnë interesat e shoqërisë së klasës kundrejt shkollës dhe autoriteteve shkollore.

Në detyrat e nxënësve dhe të nxënësve bëjnë pjesë:

- ndjekja e rregullt e shkollës,
- paraqitja në kohë,
- kryerja e detyrave mësimore,
- sjellja me vete e të gjitha materialeve të nevojshme,
- pjesëmarrja në lëndët e fizkulturës dhe të notit si dhe
- në ekskursionet e klasës dhe në udhëtime.

Kërkohej, që ata të trajtojnë shoqet dhe shokët e tyre të klasës, mësuesit dhe personelin tjetër të shkollës me respekt dhe mirëdashje. Nuk lejohet ushtrimi i dhunës kundër personave dhe sendeve.

Fëmijët në Gjermani kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe diskriminimi. Kjo do të thotë për shembull, që asnjë fëmijë nuk lejohet të rrihet.

Fëmijët gjithashtu kanë të drejtën e ndjekjes së shkollës. Nëse prindërit e tyre kanë pak të ardhura ose nuk kanë fare të ardhura, atëherë ata mund të marrin pagesa përkrahjeje me kartën berlinpass-BuT nga pakoja e arsimit.

KËSHTU PRINDËRIT MUND TË MARRIN PJESË NË MODELIMIN E SHKOLLËS



Në Gjermani, ju keni të drejtën të kontribuoni në shkollë.
Gjithashtu ka shumë rëndësi dhe kërkohet, që ju t'i përkrahni fëmijët tuaj.

Të drejtat tuaja të bashkë-vendosjes dhe të bashkëpunimit

Afërsisht tri deri në katër herë në vitin shkollor zhvillohen në çdo klasë mbledhjet e prindërve. Në fillimin e vitit shkollor, në këto mbledhje zgjidhet një përfaqësim prindëror nga prindërit. Përfaqësimi prindëror përfaqëson interesat e prindërve resp. të personave me të drejtën prindërore kundrejt shkollës dhe autoriteteve shkollore.

Mbledhjet prindërore dhe ditët për bisedat me prindërit

Për t'u informuar ka shumë rëndësi, që të merrni pjesë në mbledhjet prindërore dhe në ditët për bisedat me prindërit, që zhvillohen rregullisht. Nëse akoma nuk flisni aq mirë gjermanisht, ndoshta mund të bëni një marrëveshje me prindërit të tjerë, mund të organizoni një përkthyes ose mund të mendoni bashkërisht me mësuesin kujdestar, se si mund të zgjidhet ky problem.



Me shumë informacione për bashkëpunimin në shkollë



Të flisni me mësuesin kujdestar

